



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received/Delivery	23.05.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHUMSHUK	4377	2023	113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.648/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtare, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.648/2023 të datës 18.04.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit, Shërbimi Korrektues i Kosovës në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.648/2023 e datës 18.04.2023, e parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën e punës "Zyrtar për punë sociale" në Qendrën Korrektuese në Lipjan, me datë 18.04.2023 përmes e-mailit ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3625/2023 të regjistruar me numër A.nr.648/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 1204 të datës 21.11.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.05.2023 përmes e-mailit ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 15.05.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 3625/2023 të datës 18.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga T.K. për ankesa.kpmsheck@rks-gov.net i datës 18.04.2023; Ankesë e ankuesit me numër protokolli 1236 i datës 25.11.2022; Vendim nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës me numër protokolli 1204 i datës 21.11.2022; E-mail i datë 18.11.2022; E-mail nga M.S. për A.D. i datës 18.11.2022; E-mail nga A.D. për T.H. 28.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 10.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 15.05.2023; Akt Emërim i T.H. i datës 27.03.2013; Ndryshim dhe Plotësim i Akt Emërimit i V.G. i datës 18.08.2020; Përskrimi i detyrave të punës për pozitën "Zyrtar për punë sociale" i datës 10.10.2011; E-mail nga M.S. për Xh. I. i datës 05.03.2023; E-mail nga A.D. për M.S. i datës 28.03.2023; E-mail nga A.D. për N.R. etj. i datës 28.03.2023; E-mail nga N.R. për A.D. i datës 24.03.2023; E-mail nga A.D. për H.M. etj. i datës 21.11.2022; E-mail nga S.G. për A.D. i datës 21.11.2022; E-mail nga M.S. për A.D. i datës 18.11.2022; E-mail nga A.D. për C.Z. i datës 16.05.2023; Konkurs Lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar i Lartë për Trajtimin e të Burgosurve dhe të miturve si dhe çështje sociale" i datës 08.11.2021; Njoftim i datës 03.12.2021; Vendim nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës me numër protokolli 0004 i datës 05.01.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi në bazë të Akt Emërimit të datës 27.03.2013, është konstatuar se ankuesi është i emëruar në pozitën e punës "Zyrtar për punë sociale" në Qendrën Korrektuese në Lipjan, në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Ankuesi më datë 25.11.2022 ka bërë ankesë tek Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të SHKK-së me pretendimin ankimor se caktimi i "Zyrtares për Punë Sociale" në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë V.G. në pozitën e punës "Zyrtare për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve" në Drejtoratin për trajtim të burgosurve dhe të miturve në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës është diskriminues dhe i padrejtë sepse personi i caktuar nuk e plotëson asnjë kriter profesional që i përgjigjet kësaj pozite.

Ndërsa më datë 28.03.2023, ankuesi ka marrë një përgjigje nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës në lidhje me ankesën me numër 1236 të datës 25.11.2022, duke rekomanduar ankuesin që kompetentë në lidhje me ankesat e nëpunësve civil është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ndërsa ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas marrjes së kësaj përgjigjeje nga organi i punësimit, poashtu pretendon se vendimi me nr.1204 i datës 21.11.2022 për transferim të përkohshëm të V.G nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës nuk ka bazë ligjore dhe se nuk ka pasur fare të drejtë të caktohet në këtë pozitë duke kërkuar që Këshilli ta anuloj këtë vendim dhe të aprovohet në tërësi ankesa e tij.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se çdo nëpunës

civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke ju referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...".Kolegji vlerëson se me vendimin e kundërshtuar me ankesë, përveç që nuk janë respektuar afatet ligjore të adresimit të ankesës në këshill nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, fakt ky që nuk është pretenduar as nga ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kështu që bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë se ankesa A.nr.648/2023 e datës 18.04.2023, e parashtruar nga ankuesi Tefik Halili është e papranueshme.

Bazuar në të gjeturat si më lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.648/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

